



Nr. Gj - 1084/2025

Datë: 22.01.2026

Në mbështetje të nenit 21, 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 20 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, përkitazi me ankesën nr.1084, të parashtruar më datën 15.09.2025 nga pala ankuese X. X., ndaj Komunës së Prishtinës, për mosofrimin e qasjes ndaj dokumenteve publike, sipas kërkesës për qasje, të parashtruar më 03.09.2025, Agjencia për Informim dhe Privatësi nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Shqiptohet gjobë ndaj Komunës së Prishtinës për moszbatimin e plotë të vendimit Nr. A-1084/2025 të datës 24.09.2025, në shumën prej €3,000.00 (tremijë eurosh) për mosofrimin e qasjes në dokumente publike.
2. Obligohet Komuna e Prishtinës që shumën prej €3,000.00 (tremijë eurosh) ta paguajë, në afat prej 30 ditësh, në xhirollogarinë e autoritetit kompetent për shqiptimin e gjobës administrative nr. 1000400070005127/ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
3. Me kalimin e afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, i njëjti kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga përmbaruesi privat.
4. Vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas pranimit të vendimit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 20, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, Agjencia ka pranuar një ankesë nga pala X. X., me nr. të protokollit 1084, të datës 15.09.2025, të ushtruar ndaj Komunës së Prishtinës, për mosofrim të qasjes ndaj dokumenteve objekt kërkesë, të përmendur në pikën 2.1 dhe 2.2 të dispozitivit të vendimit A-1084/2025 të datës 24 shtator 2025.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Agjencia, përveç ndjekjes së procedurës së rregullt, përmes shkresës njoftuese të datës 15 shtator 2025, ka nxjerrë vendimin A-1084/2025 të datës 24 shtator 2025, në pajtim me nenin 20, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente

Publike, ka obliguar Komunën e Prishtinës që t'i ofrojë palës dokumentet publike në përputhje me pikat nga 2.1 dhe 2.2 të dispozitivit të të njëjtit.

Komuna e Prishtinës, pavarësisht gatishmërisë për t'a ftuar palën ankuese që ti ofronte qasje të pjesshme (në shikim), nuk e ka zbatuar vendimin detyrues të AIP-së.

Ofrimi i qasjes ndaj këtyre dokumenteve, të cilat lidhen me shpenzimin e parasë publike dhe me ushtrimin e funksioneve publike të zyrtarëve publikë, qasja ndaj të cilave garantohet me nënparagrafin 3.1 dhe 3.2 të nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.

Për shkak të mosreflektimit të institucionit publik për të ofruar qasjen e rekomanduar nga autoriteti mbikëqyrës, Agjencia për Informim dhe Privatësi, më 12 nëntor 2025 i ka dërguar institucionit publik Njoftimin Nr.1084/2025 për Shqiptimin e Gjobës Administrative, ndaj të cilit, Komuna e Prishtinës nuk ka reaguar.

Agjencia për Informim dhe Privatësi, duke vënë re qasjen mospërfillëse të këtij institucioni publik për të jetësuar të drejtën e palës ankuese, është detyruar të vazhdojë me hapin e radhës të shqyrtimit të kësaj ankese, duke nxjerrë Vendimin Nr. Gj-1084/2025, përmes të cilit i shqiptohet gjobë institucionin publik në fjalë, shuma e së cilës bazohet në paragrafin 3 të nenit 33 të Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.

Siç është përshkruar në arsyetimin e lartcekur dhe bazuar në nenin 20, nënparagrafi 4 të Ligjit për Qasje e në Dokumente Publike, Agjencia ka marrë vendimin e paraqitur në dispozitiv.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë padi për kundërshtim në gjykatën kompetente për çështje administrative brenda 30 (tridhjetë) ditësh, nga data në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Jeton Arifi
Drejtore
Departamenti për Qasje
në Dokumente Publike

Vendimi i dërgohet:

- Z. Përparim Rama, Zyrtar Përgjegjës, Komuna e Prishtinës
- X. X., Ankues
- Arkivit të Agjencisë